



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 697, datë 21.11.2023

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjorë në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarën {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Ajo ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve civile në funksion të zgjidhjes së saktë të çështjes dhe është e aftë të identifikojë rastet, kur zbatohet ligji specifik apo ligji më i hershëm në kohë. Tre dokumentet e përzgjedhura prej saj dhe 5 dosjet gjyqësore, konfirmojnë njohuritë në të drejtën civile materiale dhe procedurale, ku bien në sy e drejta e pronësisë (shih dokumentin 1

dhe dosjen 3), afatet e ekzekutimit të titujve ekzekutivë (shih dokumentin 2), të drejtën e njohjes pronar (shih dosjen 3), shpërblimi i dëmit (shih dosjen 1), vërtetimi i faktit juridik të marrëdhënieve të punës (shih dosjen 2), likuidimi i shoqërive tregtare (shih dosjen 4). Gjithashtu, ajo ka njohuri edhe për masat e sigurimit personale (shih dosjen 5). Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4). Në çështjet adm-penale, i kushton rëndësi rrethanave që përlligjin ose jo arrestimin e personave nën hetim dhe nëse masa e sigurimit të kërkuar nga organi i prokurorisë, i përshtatet ose jo kërkesave dhe kritereve ligjore të parashikuara nga ligji (shih dosjen 5)....”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Fakti juridik civil apo penal vjen gjithmonë i integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, tregtar apo kërkesë me objekt vlerësim arresti dhe caktim mase sigurimi*), rrethanat e fakteve parashtrihen në fillim të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit, pas parashtrimit të disa rrethanave procedurale. Evidentohet analizë e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në një nga çështjet civile objekt shqyrtimi, referuar natyrës së vendimit, gjyqtarja është ndalur vetëm në pasqyrimin dhe analizën e fakteve me natyrë procedurale, konkretisht atyre të lidhura me rastin e heqjes dorë nga e drejta e padisë dhe pasojat e kësaj kërkesë, përcaktuar kjo nga natyra e vendimit gjyqësor, i cili është vendim për rrëzimin e padisë, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e padisë.¹

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik civil, fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre,² por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Gjithashtu, në nxjerrjen e faktit juridik, gjyqtarja bazohet jo vetëm në provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, por edhe në kryerjen e akteve ekspertimeve në ato raste kur për zgjidhjen sa më drejtë të çështjes nevojiten njohuri të posaçme.³ Në të gjitha vendimet gjyqësore konstatohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes***

¹Vendimi nr.61, datë 15.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²Vendimi nr.3873, datë 09.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³Vendimi nr.6395, datë 18.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile apo tregtare. Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtarja përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje pronësie, pavlefshmëri titulli ekzekutiv, marrëdhënie pune, lirim dhe dorëzim sendi etj.*), apo në çështjet tregtare. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj dhe që përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467 paragrafi 1, shkronja “a” i K.Pr.Civile dhe këtë e pasqyron në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese duke analizuar juridiksionin dhe kompetencën e saj (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes.⁴ Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara, por edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

- **Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm**

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, evidentohet se në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në një pjesë të veçantë ose në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendim kërkesë penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar si dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Punës, Kodit të Familjes, ashtu edhe ligjeve organike përkatëse, që kanë lidhje kryesisht me:

- *Pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së aksioneve,*⁵ ku gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale nenet 92, 93, 94, 106 të K.Civil në lidhje me pavlefshmërinë e veprimit juridik dhe pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik. Po kështu, ligjin e posaçëm nr. 8794, datë 10.05.2001 “*Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”*”, në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit juridik. Gjithashtu, citon dhe identifikon nenet 208 dhe 231 të K.Civil në lidhje me bashkëpronësinë në pjesë dhe bashkëpronësinë ndërmjet bashkëshortëve; nenet 66, 73, 74, 90, 91, 92, 93, 94, dhe 96 të Kodit të Familjes në lidhje me regjimin pasuror martesor të bashkëshortëve, bashkësinë ligjore, përbërjen e bashkësisë ligjore, administrimi i bashkësisë, administrimi jo i zakonshëm nga njëri bashkëshort, refuzimi i pëlqimit, zëvendësimin në administrim, tejkalimin e të drejtave nga njëri prej bashkëshortëve dhe

⁴Vendimi nr.11582, datë 03.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁵Vendimi nr.3873, datë 09.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

mbarimin e bashkësisë; nenet 112 dhe 117 të K.Civil në lidhje me shuarjen e të drejtës së padisë dhe fillimin e afatit të parashkrimi të të drejtës së padisë.

- *Padinë reale të kërimit të sendit (padia e rivendikimit),*⁶ duke identifikuar për këtë qëllim jo vetëm normën relevante për zgjidhjen e çështjes, nenin 296 të K.Civil, por njëkohësisht edhe dispozitën materiale civile që ka lidhje me normën kryesore, nenin 297 të K.Civil lidhur me të drejtat e poseduesit për të ardhurat apo edhe ligjin e posaçme për fitimin e pronësisë ligjin nr. 9482, datë 03.06.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, i ndryshuar, në funksion të argumentimit se gjendja e posedimit prej 10 vjetësh, nuk mund të konsiderohet një posedim i përkohshëm, dhe si rrjedhojë ka cenuar të drejtën e pronarit për të realizua të drejtat e tij që rrjedhin nga sendi.
- *Lidhur me padinë për mbrojtjen e markave tregtare,*⁷ gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 140, 156, 184/a dhe 184/b të ligjit nr.9947, datë 07.07.2008, “*Për pronësinë industriale*”, i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e shenjave që përbëjnë markë, individualizimin e të drejtave që rrjedhin nga regjistrimi i markës, e drejta për të vepruar kundër shkeljes së të drejtave, si dhe procedura që ndiqen në rast shkelje.
- *Likuidimin e shoqërisë tregtare,*⁸ gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 1, 9 dhe 204 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, në lidhje me objektin e ligjit, përkufizimet dhe regjistrimet e detyrueshme, në funksion të argumentimit se zyra e përfaqësimit nuk është shoqëri tregtare dhe si e tille ajo nuk mund t’i nënshtrohet asnjë procedure prishje, në formën e likuidimit të zakonshëm apo të thjeshtëzuar.
- *Në kërkesën për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla,*⁹ gjyqtarja identifikon dispozitën ligjore materiale dhe procedurale, nenin 517 të K.Pr.Civile, në lidhje me të drejtën e debitorit gjatë fazës së ekzekutimit vullnetar për t’iu drejtuar gjykatës me kërkesë për shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ndarjen e këtij detyrimi me këste.
- *Detyrimet që rrjedhin nga mospërbushja e marrëdhënieve kontraktore,*¹⁰ duke cituar dhe identifikuar për këtë qëllim si dispozitën e përgjithshme të lindjes së detyrimeve (*neni 419 të K.Civil*) ashtu edhe dispozitat materiale në lidhje me marrëdhënien juridike të detyrimit konkret dhe pasojat që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimit (*nenet 476 dhe 698 i K.Civil*).
- *Shpërblimin e dëmit që buron nga zgjidhja e marrëdhënies së punës,*¹¹ ku gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 4, 12, 141, 143, 144, 153, 155 të Kodit të Punës, në funksion të vlerësimit mbi zbatimin e Kodit të Punës, përkufizimit të marrëdhënies juridike të punës, llojin e kontratës, formën dhe përmbajtjen e saj, rastet, procedurën, afatin dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës dhe pasojave që vijnë prej zgjidhjes së marrëdhënies së punës.
- *Lidhur me mjetet juridike në fazën e ekzekutimit (padia për pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë apo kërkimin e sendit nga personi i tretë),* gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (*nenet 609, 610 të K.Pr.Civile dhe nenet 612, 563 të K.Pr.Civile*) në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv apo kërkimin e sendit nga personi i tretë, analizën e këtyre mjeteve të posaçme juridike të fazës së ekzekutimit.¹² Identifikon dhe citon nenet 850 dhe 705 të K.Civil në lidhje me kontratën e sipërmarrjes dhe kontratën e shitjes, në funksion të përcaktimit të llojit të kontratës të lidhur mes palëve; nenet 92/a dhe 106 të K.Civil në lidhje me pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik dhe pasojat e pavlefshmërisë së veprimit juridik.¹³

Krahas dispozitave të Kodit Civil, Kodit të Punës dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve

⁶Vendimi nr. 6395, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁷Vendimi nr.615, datë 03.02.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁸Vendimi nr.1373, datë 23.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁹Vendimi nr.5015, datë 16.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁰Vendimi nr.8293, datë 02.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹¹Vendimi nr.5353, datë 30.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹²Vendimi nr.11064, datë 17.11.2014 dhe nr.3265, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹³Vendimi nr.5353, datë 30.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, konkretisht neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ-së, lidhur me të drejtën e pronësisë dhe mbrojtjen e saj.¹⁴

Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, në çështjet civile, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën hyrëse të pjesë përshkruese-arsyetuese, por edhe në pjesën e vlerësimit të gjykatës, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- nenin 16 të K.Pr.Civile lidhur me detyrimin e gjykatës për të bërë një cilësim të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët; nenet 106 apo 107/2 të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e detyrimit për pagimin e shpenzimeve gjyqësore;¹⁵
- nenet 36/1 dhe 388/2 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes. Neni 388 të K.Pr.Civile, për të vlerësuar legjitimitetin e kërkesit në ngritjen e kërkesës për vërtetimin e faktit juridik;¹⁶
- nenin 201/2 të K.Pr.Civile në lidhje me disponimin për rrëzimin e padisë, për shkak të kërkesës të paditësit për heqje dorë nga e drejta e padisë;¹⁷
- nenin 317 të K.Pr.Civile në lidhje me kërkesën për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, nenin 299/b të K.Pr.Civile lidhur me disponimin për pushimin e gjykimit për një pjesë të kërtimeve, për shkak të kërkesës të paditësit për heqje dorë nga gjykimi i tyre;¹⁸
- nenin 253 të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e fuqisë provuese të akteve zyrtare;¹⁹
- nenin 267 të K.Pr.Civile në lidhje me detyrimi për të provuar se shkresa private është origjinale dhe nenet 260, 263 të K.Pr.Civile në lidhje me librat e tregtarëve, si shkresa private të cilat përbëjnë provë të plotë për sa shkruhet në to dhe lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet falsitet;²⁰
- nenin 612 të K.Pr.Civile lidhur me interesin e ligjshëm të palës paditëse për të ngritur padinë për kërkimin e sendit nga personi i tretë në fazën e ekzekutimit;²¹
- nenin 185 të K.Pr.Civile lidhur me ndryshimin e objektit të padisë;²²
- nenin 451/a të K.Pr.Civile lidhur me parimin e “gjësë së gjykuar” dhe efektet e vendimit gjyqësor të formës së prerë.²³

(ii) Në vendimin penal me objekt vleftësim e arrestit dhe caktim mase sigurimi, gjyqtarja identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizës së paligjshmërisë së arrestit (*nenin 251 të K.Pr.Penale*) dhe vlerësimit që i bëhet masës shtrënguese më të përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim (*nenet 228, 229 të K.Pr.Penale*) në lidhje me kushtet (*e përgjithshme dhe të veçanta*) dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit. Gjithashtu, gjyqtarja identifikon dispozita materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të personit të dyshuar për të cilin kërkohet vendosja e një mase sigurimi personal. Konkretisht, referon nenin 236/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “*Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik*”, kryer në bashkëpunim dhe nenin 242 të K.Penal në lidhje me veprën penale “*Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të*

¹⁴Vendimi nr.6395, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁵Pothuajse në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi

¹⁶Vendimi nr.11582, datë 03.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁷Vendimi nr.61, datë 15.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁸Vendimi nr.5353, datë 30.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

¹⁹Vendimi nr.3873, datë 09.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁰Vendimi nr.3265, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²¹Vendimi nr.956, datë 27.01.2014 dhe nr.3265, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²²Vendimi nr.6395, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²³Vendimi nr.1816, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

polici së rendit publik” me qëllim cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet personi i dyshuar.²⁴

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton aftësi shumë e lartë e gjyqtarës për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra-tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor, ndonëse në tekstin e vendimeve*

²⁴Vendimi nr.1203 akti, datë 01.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

përfundimtare i përdor në raste të rralla. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentin 3 dhe dosjet 1 e 3), por nuk referohet tek jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Gjyqtarja i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin *teleologjik*, duke identifikuar qëllimin e normës, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përjasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) Në vendimet civile: Përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin abstrakt të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja:

- a) Në funksion të analizës së natyrës juridike të kontratës së lidhur mes palëve, interpreton në mënyrë sistematike dispozitat ligjore materiale (*nenet 681, 682, 683 dhe 689 të K.Civil*) në lidhje me interpretimin e kontratës, si dhe përcaktimin se si duhet të interpretohet kontrata apo kushtet e saj. Interpreton nenet 850 dhe 705 të K.Civil lidhur me kontratën e sipërmarrjes dhe kontratën e shitjes, për të përcaktuar se cili është lloji i kontratës që palët kanë lidhur, duke analizuar qëllimin e vërtet dhe të përbashkët të palëve, qëllimin që del nga natyra e objektit të kontratës dhe përmbajtjes së të drejtave dhe detyrimeve të palëve, në kuadër të sjelljes në tërësi të palëve, para dhe pas përfundimit të kontratës.²⁵
- b) Interpreton në mënyrë literale nenin 296 të K.Civil për të përcaktuar se kush janë kushtet dhe kriteret e padisë reale të rivendikimit (*qenien pronar–legjitimimi aktiv, zhveshja nga posedimi, dhe posedimin e paligjshëm – legjitimimi pasiv*).²⁶
- c) Interpreton në mënyrë sistematike nenet 314, 73 dhe 74 të K.Familjes, me qëllim përcaktimin se veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës, ka qenë pjesë në bashkësinë ligjore ndërmjet bashkëshortëve. Në këtë kontekst, gjyqtarja interpreton dispozitat materiale të K.Familjes dhe K.Civil, të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar mënyrën e administrimit të zakonshëm dhe të jo zakonshëm, kundërshtimin dhe kërkimin e pavlefshmërisë relative të administrimit jo të zakonshëm, si dhe afatin brenda të cilit bashkëshorti i interesuar mund të kërkojë deklarimin e pavlefshmërisë së aktit të kryer.

²⁵Vendimi nr.3265, datë 10.03.2014 dhe nr.956, datë 27.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁶Vendimi nr.1816, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo dispozitë interpretohet edhe në vendimin nr.6395, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Konkretisht, gjykata interpreton nenin 90, 94 të K.Familjes, si dhe nenet 117, 112 të K.Civil, duke i interpretuar dhe analizuar në raport me faktet e çështjes.²⁷

- d) Interpreton në mënyrë literale dhe teologjike nenin 12 të K.Punës, në funksion të identifikimit të llojit të kontratës lidhur mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës. Referuar interpretimit literal dhe sistematik të bërë dispozitës materiale (*nenet 141 dhe 143 të K.Punës*), dhe rrethanave të faktit, gjyqtarja arsyeton se mënyra e zgjidhjes së kontratës së punës është ajo në mënyrë të menjëhershme pa respektuar afatin e njoftimit, e për pasojë në lidhje me këtë mënyrë përfundimi referenca ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes orientohet drejt normës materiale nenit 153 dhe 155 të K.Punës për të përcaktuar nëse shkaqet e zgjidhjes e justifikojnë këtë mënyrë përfundimi të marrëdhënies së punës me paditësin. Më tej, gjyqtarja interpreton dispozitat materiale (*nenet 155, pika 3 dhe 144/1 të K.Punës*), lidhur me dëmshpërblimin ndaj punëmarrësit për mosrespektimin e procedurës e zgjidhjes së kontratës së punës, për dëmshpërblimin për vjetërsi në punë, duke analizuar në mënyrë të detajuar provat shkresore, mbi të cilat provohen faktet e kërtimeve apo pretendimeve të palëve në gjykim.²⁸
- e) Interpreton në mënyrë literale nenin 204 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare” me qëllim përcaktimin e kushteve ligjore që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, lidhur me procedurën e likuidimit të thjeshtuar të shoqërisë tregtare. Interpreton në mënyrë sistematike nenet 1, 9 dhe 204 të ligjit nr.9901/2008 në funksion të konkluzionit se zyra e përfaqësimit nuk është një shoqëri tregtare dhe si e tillë nuk mund t’i nënshtrohet asnjë procedure prishje, në formën e likuidimit të zakonshëm apo të thjeshtuar.²⁹

(ii) Në vendimin penal me objekt vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi, gjyqtarja interpreton nenin 236/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, kryer në bashkëpunim dhe nenin 242 të K.Penal në lidhje me veprën penale “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të personit të dyshuar për të cilin kërkohet vendosja e një mase sigurimi personal.³⁰

-Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale:

Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtarja i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht:

- a) Gjyqtarja interpreton në përputhje me faktin dhe ligjin (nenin 451/a të K.Pr.Civile), institutin e gjësë së gjykuar në mënyrë të detajuar e duke vlerësuar se në rastin konkret pretendimet e palës paditëse kanë rënë në dekadencë, jo vetëm për shkak të faktit se nuk janë parashtruar as në formën e prapësimit në gjykimin e mëparshëm, por edhe për shkak të faktit se këto pretendime për pavlefshmëri absolute të

²⁷Vendimi nr.3873, datë 09.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁸Vendimi nr.5353, datë 30.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

²⁹Vendimi nr.1373, datë 23.02.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁰Vendimi nr.1203 akti, datë 01.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

veprimet juridik në këtë gjykim kanë marrë formën e “gjësë së gjykuar së nënkuptuar” për sa kohë janë zgjidhur me vendim të formës së prerë në një gjykim tjetër civil.³¹

- b) Interpreton nenet 517/3 të K.Pr.Civile, lidhur me të drejtën e debitorit që gjatë fazës së ekzekutimit vullnetar, të kërkoj shtyrjen e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla ose ndarjen e këtij detyrimi me këste.³²
- c) Në çështjen civile në të cilën gjykimi ka përfunduar për shkaqe procedurale, gjyqtarja analizon dispozitën përkatëse (*neni 201/2 të K.Pr.Civile*) në drejtim të përcaktimit të natyrës së institutit të heqjes dorë nga e drejta e padisë dhe pasojën e kësaj kërkesë, rrëzimin e padisë.³³

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtares për të përdorur jurisprudencën relevante

Në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe vendime të Gjykatës Kushtetuese*) në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht, identifikohet:

- Vendimi unifikues nr.3, datë 29.03.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me shkakun ligjor dhe objektin e padisë,³⁴ vendimin unifikues nr.932, datë 22.06.2000 në lidhje me veprimin juridik fiktiv dhe të stimuluar.³⁵
- Vendimi unifikues nr.24, datë 13.03.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me natyrën dhe qëllimin e ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish pronarëve”, si dhe nocionin “*kthim i pronës*”.³⁶
- Vendimi nr.484, datë 25.04.2006 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, lidhur me fuqinë detyruese dhe pandryshueshmëria e vendimit gjyqësor të formës së prerë.³⁷
- Vendimi nr.39, datë 16.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese lidhur me procedurën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, si një fazë ndërmjetëse dhe jo procedurë përfundimtare. Vendimi nr.76, datë 16.02.2012, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë lidhur me padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, nga përmbajtja e së cilës rezulton se bëhet fjalë për “*goditjen e titullit ekzekutiv*” dhe pavlefshmëria është vetëm njëri nga motivet e ngritjes së kësaj padie.³⁸

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtares që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njih, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

³¹Vendimi nr. 1816, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³²Vendimi nr. 5015, datë 16.06.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³³Vendimi nr.61, datë 15.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁴Ky vendim unifikues referohet edhe në vendimet nr.6395, datë 18.07.2016, nr.615, datë 03.02.2015 nr.8293, datë 02.11.2015, nr.1816, datë 07.03.2016, nr.956, datë 27.01.2014, nr.3265, datë 10.03.2014, nr.11064, datë 17.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁵Vendimi nr.3873, datë 09.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁶Vendimi nr.6395, datë 18.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁷Vendimi nr.1816, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

³⁸Vendimi nr.11064, datë 17.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

- *Parimet themelore të procesit gjyqësor civil të parashikuar në nenet 10, 11, 12, 14, 16, etj. (procesi i rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.), mbi bazën e të cilave gjykata disponon për bazueshmërinë ose jo të padisë.*
- *Parimin “Juria novit curia”, sipas të cilit gjykata njeh ligjin, në funksion të evidentimit se gjykata ka detyrimin për të bërë cilësim të saktë të fakteve, pa u lidhur me përcaktimin që bëjnë palët.*
- *Parimin e sigurisë juridike në raport me konceptin e vendimit të formës së prerë dhe efektet detyruese të tij.³⁹*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Dispozitat e ligjit material rezulton të jenë referuar dhe interpretuar në mënyrë konsistente, duke i zbërthyer paraprakisht në elementë përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës para aplikimit të saj mbi faktet e çështjes konkrete. Evidentohet kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor,

³⁹Vendimi nr.1816, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

por nuk i ka përdorur gjithmonë të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore... ”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjyqimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore përfundimtare, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në kllapa), duke u shoqëruar gjithnjë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke mos krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre.⁴⁰ Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit,⁴¹ përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Jo gjithmonë rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

Në disa nga vendimet e analizuara evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme,⁴² por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara. Prezenca e këtyre elementëve, në disa raste në mënyrë tepër

⁴⁰Për shembull: “*Iura novit curia*”; “*sui generis*”; “*res iudicata*”; “*exceptio rei iudicatae*”; etj.

⁴¹Vendimi nr.6395, datë 18.07.2016 dhe nr.8293, datë 02.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴²Shih p.sh.(i) vendimin nr.3873, datë 09.05.2016 në të cilin citohen nenet 92, 93, 94, 106, 199, 208, 231, 112 dhe 117 të K.Civil, neni 20 i ligjit nr.8794, datë 10.05.2001; neni 62 i ligjit nr.97/2013; nenet 66, 314, 73, 74, 90, 91, 92, 93, 94, 96 të K.Familjes; (ii) Vendimin nr. 5353, datë 30.04.2014 në të cilin citohen nenet 4, 12, 141, 144, 145, 153 dhe 155 të K. Punës; (iii) Vendimin nr. 3265, datë 10.03.2014 në të cilin citohen nenet 612, 563, 560, 92/a, 79, 659 dhe 106 K.Civil; nenin 3 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 dhe nenin 41/a të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994.

të detajuar, gjithsesi i jep qartësi elementëve procedurale të gjyqimit ose vendimit dhe nuk cenon koncizitetin e tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet me argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumentave ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*), etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat*

e legjislacionit procedural civil (shih dokumentet 1, 2 e 3 dhe dosjet 1, 2, 3 e 4) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dosjen 5)... Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja ndjek një metodologji të qartë, duke iu referuar pjesëve përbërëse të vendimit. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe objekti i kërkesës në çështjet penale*), baza ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë, në të cilat në mënyrë të detajuar gjyqtarja analizon: (i) elementët proceduralë të vlerësuar nga gjykata (juridiksioni, kompetenca), vlerësimi për kërkesat procedurale të palëve, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) faktet thelbësore të çështjes objekt shqyrtimi, të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (iii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iv) ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale, por edhe ato të ligjit të posaçëm, ku të referon fakti juridik civil për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe (v) vlerësimi i gjykatës, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe konkluzion mbi çështjen.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (*pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë*), por njëkohësisht edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe tregtare dhe (ii) nenin 245 të K.Pr.Penale, në vendimin e kërkesës së hetimeve paraprake. Po kështu, vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë dhe nëndarje, çka lehtëson kuptueshmërinë e arsyetimit të gjykatës për çdo pretendim të ngritur, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e

shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁴³

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentin 3 dhe dosjet 2 e 3). Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cënuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.....Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo i

⁴³Vendimi i GJEDNJ, çështja *Hadjanastassiou vs Greqisë*, datë 16.12.1992, fq.33.

kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsytimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, rezulton një nivel shumë i mirë arsytimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjyqimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë, etj.

Arsytimi i vendimeve burim vlerësimi ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Pasi dispozita zbërthehet dhe interpretohet në kuptimin abstrakt, ajo vijon të aplikohet mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të zgjidhjes së çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi gjyqtarja kujdeset për të evidentuar në mënyrë të qartë thelbin e konfliktit/çështjes, duke orientuar analizën juridike dhe duke zhvilluar argumentimin logjik të saj, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi evidentimit dhe argumentimit ligjor në drejtim të marrëdhënies shkak-pasojë, në përjasjen e ligjit me faktet konkrete. Arsytimi i vendimeve është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim nga gjyqtarja.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtarja i kushton rëndësi analizës më të zgjeruar së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh:

- (i) Institutit juridik të dëmshpërblimit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme elementët e kontratës së punës, formën e saj, procedurën dhe afatet e zgjidhjes së kontratës, shkaqet e justifikuara, pasojat që vijnë nga mosrespektimi i dispozitave ligjore nga ana e punëdhënësit;⁴⁴
- (ii) Mjeteve të posaçme të mbrojtjes gjatë fazës së ekzekutimit duke analizuar dispozitën procedurale që parashikon padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, apo të drejtën e kërimit të sendit nga personi i tretë;⁴⁵
- (iii) Analizën e institutit të pavlefshmërisë së veprimit juridik në kuptim të nenit 92/a të K.Civil. Në këtë kontekst gjykata ndalet tek hipotekimi i sendeve të paluajtshme, i cili bëhet vetëm me pëlqim të pronarit të sendit, si element detyrues i parashikuar në nenin 560 të K.Civil, si dhe të pasojat e veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm;⁴⁶
- (iv) Institutit të gjësë së gjykuar, analizë të cilën e bën jo vetëm në këndvështrimin teorik, por duke iu referuar për këtë qëllim edhe jurisprudencës relevante në lidhje me këtë institut e duke u nisur nga këto përcaktime të konkludojë në përputhje me faktin konkret se jemi para ekzistencës së gjësë së gjykuar;⁴⁷
- (v) Institutin e bashkësisë ligjore ndërmjet bashkëshortëve, si një bashkëpronësi me një regjim juridik të posaçëm, në funksion të vlerësimit të saj mbi shkakun ligjor të padisë. Në këtë rast gjyqtarja ndalet edhe në analizën dhe përjasjen me pas me rrethanat e faktit, të institutit të parashkrimit të padisë, duke identifikuar momentin e fillimit të afatit të parashkrimit, kohëzgjatjen dhe pasojat e kalimit të tij, për të konkluduar mbi bazueshmërinë e pretendimit të palës së paditur për parashkrimin e padisë.⁴⁸

⁴⁴Vendimi nr.5353, datë 30.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁵Vendimi nr. 956, datë 27.01.2014, nr.11064, datë 17.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁶Vendim nr.3265, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁷Vendim nr.1816, datë 07.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

⁴⁸Vendim nr.3873, datë 09.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

*Në vendimin për kërkesën penale mbi vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit,*⁴⁹ karakteristikë e gjyqtarës është paraqitja dhe analiza e detajuar e rrethanave mbi bazën e të cilave është paraqitur kërkesa e prokurorisë. Gjyqtarja integron në mënyrë të natyrshme rrethanat e rezultuara me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm si në drejtim të verifikimit të kushteve të flagrancës, ashtu edhe të caktimit të masës së sigurimit. Gjithashtu, gjyqtarja ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të dyshuarit në raport me arrestimin e tij në flagrancë dhe nevojës për caktimin e masës së sigurimit.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.) Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsytimit (por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret), pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm, si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë aplikim në rastin konkret. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARËS	
Niveli i vlerësimit	Pikët

⁴⁹Vendim nr.1203 akti, datë 01.11.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile... Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} nuk ka qenë gjithnjë brenda afateve standard apo ligjore, por në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 2 vjet 3 muaj e 4 ditë (shih dosjen 3)...”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja dhe vendimeve të administruar për shkak referimi nga ish/Inspektorati i KLD-së për tu mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 (dy) vendimeve të administruar për shkak referimi nga ish/Inspektorati i KLD-së për tu mbajtur parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e gjykimit.

Konkretisht:

- (i) Çështja e kategorisë “Kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake” (*vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor për përfundimin, afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë. Referuar vendimit nr. 1203 akti, datë 01.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se kërkesa për vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës ka si datë regjistrimi datën 31.10.2013 dhe datë vendimi datën 01.11.2013. **Rezulton që është respektuar afati 48 orë i parashikuar në nenin 259/5 të K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**
- (ii) Çështja civile me nr. regjistri 7708, datë regjistrimi 20.04.2015, me objekt “Shtyrje e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla dhe ndarjen e tij në këste”, përfunduar me vendimin nr.5015, datë 16.06.2015,⁵⁰ **rezulton të ketë përfunduar për një afat prej 1 muaj e 27 ditë, ndërkohë që neni 517/3 i K.Pr.Civile,⁵¹ parashikon afatin 20 ditor të gjykimit.** Referuar të dhënave në vendimin e rivlerësimit⁵² rezulton se për zhvillimin e gjykimit janë zhvilluar gjithsej 6 (gjashtë) seanca, nga të cilat 1 (një) seancë përgatitore dhe 5 (pesë) seanca gjyqësore. Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit nuk ka të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes, pasi ky vendim është vendim i përzgjedhur nga ana e gjyqtarës, për të gjykuar mbi veprimet e ndërmarra prej saj për administrimin e çështjes.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuar më sipër në të cilat për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe prej tyre 1 (një) çështje ka përfunduar brenda afatit ligjor (48 orë sipas nenit 259 të K.Pr.Penale) ndërsa 1 (një) çështje ka përfunduar tej afatit ligjor 20 ditor të parashikuar nga neni 517, pg 3 i K.Pr.Civile, rezulton se raporti i çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është 50%.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 50% përkon me nivelin e vlerësimit 3 (tre) pikë. Megjithatë, përveç analizës matematike, vlerësuesi duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke konsideruar i) natyrën e çështjes, e cila për edhe pse për mënyrën se si investon gjykatën bëhet nëpërmjet mjetit procedural “kërkesë”, ajo detyron gjykatën për dëgjimin e kreditorit, çka do të thotë që çështja nuk mund të shqyrtohet sipas ligjit procedural të kohës në dhomë këshillimi, por në seancë gjyqësore, duke i dhënë mundësi edhe kreditorit “person i tretë” të paraqesë prova në gjykim, të cilat rezultojnë të jenë administruar e analizuar nga gjyqtarja; ii) masën e tejkalimit të afatit me 1 muaj e 7 ditë; iii) pamundësinë për të analizuar e gjykuar mbi veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja për administrimin e çështjes, pasi vendimi ka qenë i përzgjedhur nga gjyqtarja, por ndërkohë mbi bazën e shpjegimeve të dhëna prej saj gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, vetë organet e rivlerësimit kanë konsideruar se kjo çështje duhej të konsiderohej e gjykuar brenda afatit pa bërë dallimin e afatit ligjor me standardin minimal, pra e kanë trajtuar çështjen për shkak të natyrës jo si çështje me afat ligjor; vetëm një çështje nuk

⁵⁰Një nga tre çështjet e përzgjedhur nga gjyqtarja për vlerësim

⁵¹Neni 517, paragrafi 3 i K.Pr.Civile përcakton se: “Me kërkesë të debitorit gjykata e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit, në raste të veçanta, duke marrë parasysh gjendjen pasurore të debitorit ose rrethana të tjera të çështjes dhe pasi të dëgjojë kreditorin, mundet të shtyjë afatin e ekzekutimit të detyrimit në të holla ose të ndajë këtë detyrim në këste, përveç rasteve kur ky detyrim rrjedh nga një akt për dhënie të kredisë bankare. Vendimi jepet në seancë gjyqësore, brenda 20 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë.”

⁵²Vendimi nr.344, datë 11.02.2021 i KPK, faqja 29

mund të mund të shërbejë si përcaktuese e shkallës së aftësisë së gjyqtarës në lidhje me këtë tregues.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të gjitha të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet 15 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} nuk ka qënë gjithnjë brenda afateve standard apo ligjore, por në intervale kohore nga 1 ditë (shih dosjen 5) deri në 2 vjet 3 muaj e 4 ditë (shih dosjen 3). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qënë çështje civile, lirim e dorëzim trualli, e shqyrtuar në 32 seanca, me 6 palë dhe me tre kërkime, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimit të pjesshëm, vendim i cili është ankimuar nga palët dhe është lënë në fuqi nga shkalla e dytë e gjykimit. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 27 ditë (shih dosjen 2), 11 muaj (shih dosjen 1) dhe 3 muaj e 6 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se vetëm në dy prej tyre është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor. Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit nuk mund të nxirren përfundime, pasi në të tre vendimet gjyqësore nuk ka të dhëna se kur janë regjistruar apo shortuar çështjet. Gjatë periudhës së rivlerësimit, ndaj saj rezultoi se janë paraqitur gjithsej 6 ankesa në Inspektoratin e KLD-së. 3 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndërsa 3 ankesa janë verifikuar dhe kanë rezultuar me konkluzionet : 1 ankesë është verifikuar për zvarritje gjykimi, por ka rezultuar pa shkelje nga gjyqtarja, 1 ankesë është hetuar disiplinarisht për zvarritje gjykimi dhe është vendosur t’i përcillet KLGJ-së, për t’u evidentuar në vlerësimin etik e profesional, pasi zvarritja nuk provohej të ketë ndodhur për shkak të sjelljes apo veprimeve të gjyqtarës dhe 1 ankesë është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi etik e profesional gjyqtarës (shih të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se për 10⁵³ çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendime të administruar për shkak referimi nga ish/Inspektorati i KLD-së për tu mbajtur parasysh vetëm si e dhënë statistike për efekt të vlerësimit etik dhe profesional,⁵⁴ gjykimi në përgjithësi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së.⁵⁵

Konkretisht , referuar 2 (dy) vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja, konstatohet se:

- (i) Vendimi civil nr.3265, datë 10.03.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt të padisë *“Pavlefshmëri të kontratës së hipotekimit, detyrim njohje pronar dhe përjashtim nga sekuestrimi”*. Referuar të dhënave në vendimin e KPK⁵⁶ rezulton se çështja është regjistri në datën 06.11.2013 dhe ka përfunduar në datën 10.03.2014, duke përfunduar brenda një afati prej 4 muaj e 4 ditë, ***pra brenda afatit 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (ii) Vendimi civil nr.3873, datë 09.05.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt të padisë *“Detyrim njohje pronar edhe mbi 60% të aksioneve të shoqërisë...”*. Referuar të dhënave në vendimin e KPK⁵⁷ rezulton se çështja është regjistri në datën 18.01.2016 dhe ka përfunduar në datën 09.05.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 3 muaj e 21 ditë, ***pra brenda afatit 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve tregtare.***

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short,⁵⁸ konstatohet se:

- (i) Çështja civile nr. 8357/994 regj.them, datë 13.02.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.V kundër palës së paditurit Shoqëria “Atlantik” sh.a, me objekt *“Shpërblimin e dëmit pasuror dhe jo pasuror...”*, e përfunduar me vendimin nr.61, datë 15.01.2015. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 11 muaj, ***pra tej afatit 6 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.***
- (ii) Kërkesa civile nr.15348, regj.them, datë 06.11.2014 me kërkues N.P., person të tretë DRSSH Tiranë, me objekt *“Vërtetim fakti juridik...”*, e përfunduar me vendimin nr.11582, datë 03.12.2014. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 27 ditë, ***pra brenda afatit 2 muajor të standardit minimal kohor për gjykimet civile pa palë kundërshtare.***
- (iii) Çështja civile nr. 9912/1194/371 regj.them, datë 09.04.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës A.B kundër palës së paditurit I.F. etj., me objekt *“Detyrim për lirim e dorëzim sendi...”*, e përfunduar me vendimin nr.6395, datë 18.07.2016. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar

⁵³Nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykim

⁵⁴Pa përfshirë 3 (tre) vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja, në kushtet kur në ekstremitetet e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes

⁵⁵Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: *“Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjyqimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: b. Gjykimet e mosmarrëveshje tregtare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 6 muaj... e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, jo më tej se 6 muaj... j. Gjykimi i çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 2 muaj.”*

⁵⁶ Fq. 29 e tij

⁵⁷ Fq. 30 e tij

⁵⁸Sikundër kemi analizuar nga 11 çështje të përzgjedhura me short, 1 prej tyre parashikon afat ligjor dhe 10 afat standard minimal kohor për përfundimin e tyre.

- brenda një afati prej 2 vjet 3 muaj e 4 ditë, **pra tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (iv) Kërkesa tregtare nr. 13920/3518 regj.them, datë 13.11.2015 me kërkues Shoqëria “Topal TV GmbH SRL”, person të tretë QKB, me objekt “*Likuidim me procedurë të përshpejtuar...*”, e përfunduar me vendimin nr.1373, datë 23.02.2016. Referuar të dhënave konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 3 muaj e 6 ditë, **pra tej afatit 2 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet pa palë kundërshtare.**
- (v) Çështja civile nr. 6244 regj.them, datë 18.11.2013 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës E.F kundër palës së paditurit Shoqëria “Vila Pak-Alb” sh.a, me objekt “*Përjashtimin e sendit nga ekzekutimi...*”, e përfunduar me vendimin nr.956, datë 27.01.2014. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 2 muaj e 8 ditë, **pra brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (vi) Çështja civile nr. 6915 regj.them, datë 20.12.2013 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Th.P kundër palës së paditurit OST, me objekt “*Dëshmipërblim që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës...*”, e përfunduar me vendimin nr.5353, datë 30.04.2014. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 4 muaj e 10 ditë, **pra brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (vii) Çështja civile nr. 12800 regj.them, datë 18.07.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Z.S kundër palës së paditurit Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime” sh.a, me objekt “*Pavlefshmëri titulli ekzekutiv...*”, e përfunduar me vendimin nr.11064, datë 17.11.2014. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 3 muaj e 27 ditë, **pra brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (viii) Çështja tregtare nr. 12409/1747 regj.them, datë 04.07.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Viacom International Inc kundër palës së paditurit A.A, me objekt “*Pushim cenimi të së drejtës së pronësisë mbi markat tregtare...*”, e përfunduar me vendimin nr.615, datë 03.02.2015. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 6 muaj e 26 ditë. Çështja i është caktuar gjyqtarës me short në muajin korrik të vitit 2014 dhe ka përfunduar në muajin shkurt të vitit 2015. Duke zbritur periudhën e lejes vjetore të vitit 2014 (30 ditë),⁵⁹ kjo çështje do të kishte përfunduar për 5 muaj e 26 ditë, **pra brenda afati 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve tregtare dhe e tillë do të konsiderohet.**
- (ix) Çështja civile nr. 16536/4042 regj.them, datë 15.12.2014 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës Shoqëria “Fama” kundër palës së paditurit Dh.K., me objekt “*Lirim, dorëzim sendi dhe shpërblim për përdorimin e sendit*”, e përfunduar me vendimin nr.8293, datë 02.11.2015. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 10 muaj e 16 ditë, **pra tej afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**
- (x) Çështja civile nr. 14355 regj.them, datë 26.11.2015 që u përket palëve ndërgjyqëse: paditës F.H kundër palës së paditurit F.H, me objekt “*Pavlefshmëri absolute e veprimeve juridike të kontratës së dhurimit...*”, e përfunduar me vendimin nr.1816, datë 07.03.2016. Referuar të dhënave, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 3 muaj e 5 ditë, **pra brenda afatit 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm.**

- Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “08 tetor 2013 - 08 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 6 (gjashtë) ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 2 (dy) ankesa të verifikuar për zvarritje gjykimi i janë regjistruar gjyqtarës për efekt të vlerësimit profesional dhe etik vetëm si e dhënë statistikore. Referuar të dhënave në lidhje me praktikën e trajtimit të ankesave, si më sipër rezulton se:

⁵⁹Neni 24/2 i ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes përcaktonte se “*Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht....*”.

- (i) Në lidhje me ankesën nr. 4537 prot, datë 27.12.2016, nga vendimi i Kryeinspektores me nr.442/1, datë 29.03.2017 mbi verifikimin e ankesës rezulton se: Ankuesi B.Z ankohet për veprimtarinë gjyqësore të gjyqtares lidhur me zvarritjen e gjykimit të çështjes civile të përfunduar me vendimin nr. 9657, datë 30.11.2016 me palë paditëse E.T., palë e paditur A.Z dhe B.Z, me objekt të padisë “Pavlefshmëri testamenti”. Pas verifikimit të ankesës nga ana e Inspektorëve të KLD-së rezultoi se: Çështja civile ka përfunduar për një afat prej 1 vit, 5 muaj e 29 ditë nga ana e gjyqtares {...}. Po kështu rezulton që janë zhvilluar gjithsej 21 seanca nga të cilat 4 seanca përgatitore dhe 17 seanca gjyqësore. Sipas këtij raporti rezulton se seancat përgatitore janë shtyrë: 1 seancë për të marrë pjesë gjyqtarja në hedhjen e shortit për vlerësimin e gjyqtarëve për vitin 2007-2009; 1 seancë është shtyrë për të plotësuar pala paditëse të metat e padisë; 1 seancë është shtyrë për t’i njoftuar palës në mungesë saktësimin e objektit të padisë dhe seanca e fundit është vendosur kalimi i çështjes në seancë gjyqësore. Seancat gjyqësore janë shtyrë: 1 seancë është shtyrë për të parashtruar pala e paditur prapësimet me shkrim; 1 seancë është shtyrë për të konfirmuar Instituti i Mjekësisë Ligjore kryerjen e llojit të ekspertimit të kërkuar; 5 seanca janë shtyrë për tu paraqitur eksperti mjeko-ligjor psikiatër; 2 seanca janë shtyrë për tu kryer akti i ekspertimit; 1 seancë është shtyrë për të paraqitur pala paditëse disa prova ekspertëve; 1 seancë është shtyrë për tu njohur palët me aktin e ekspertimit; 1 seancë është shtyrë për të saktësuar paditësi objektin e padisë; 1 seancë është ndërprerë për shkak të paraqitjes së kërkesës së palës së paditur për përjashtim gjyqtari; 1 seancë është shtyrë për paraqitjen e pretendimeve me shkrim; 1 seancë është shtyrë për shpallje vendimi dhe seanca e fundit është shpallur vendimi përfundimtar. Në raportin Inspektoratit të KLD është konkluduar se në rastin konkret çështja ka përfunduar tej afatit standard të përcaktuar (6 muaj sipas vendimit 261/2010 të KLD-së) duke e tejkaluar këtë afat me 11 muaj e 29 ditë dhe ky rast t’i evidentohet gjyqtares në vlerësimin etiko-profesional vetëm si e dhënë statistikore, pasi zvarritja nuk provohet të ketë ndodhur për shkak të sielljes apo veprimeve të gjyqtares.
- (ii) Në lidhje me ankesën nr. 1829 prot, datë 29.05.2016, nga relatiimi datë 29.12.2017 mbi verifikimin e ankesës rezulton se: Ankuesi N.H ankohet për zvarritjen e gjykimit të çështjes civile të gjykuar prej gjyqtares {...}, në cilësinë e kryesueses të trupit gjykues, të përfunduar me vendimin nr. 2211, datë 17.03.2016 me palë paditëse H.H., M.H. dhe Xh.H., palë e paditur Shoqëria “Sigal Unica Austria”, me objekt “Shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror”. Pas verifikimit të ankesës nga ana e Inspektorëve të KLD-së rezultoi se: Çështja civile i është caktuar gjyqtares me short në datën 11.06.2014 dhe ka përfunduar me vendimin e datës 17.03.2016, duke përfunduar për një afat prej 1 vit, 9 muaj e 6 ditë nga momenti i caktimit me short. Gjithashtu, në ecjen e afatit të gjykimit të çështjes nuk duhet të përlllogaritet edhe periudha e pushimeve vjetore (*në muajin gusht 2014 dhe muajin gusht 2015*) të cilat e rrisin edhe me 2 muaj përfundimin e gjykimit të çështjes. Në këtë kontekst, nëse do të zbresim edhe këto dy muaj do të rezultonte që çështja është përfunduar nga ana e gjyqtares {...} për një kohë prej 1 vit, 7 muaj e 6 ditë nga momenti i marrjes së kësaj çështje në short. Po kështu sipas këtij raporti lidhur me planifikimin e seancave gjyqësore rezulton të jenë planifikuar 22 seanca nga të cilat 3 seanca përgatitore, si dhe 19 seanca gjyqësore. Janë zhvilluar 21 seanca, 1 nuk është zhvilluar për mungesë të anëtarit të trupës gjykuese A.A. Planifikimi i seancës së parë përgatitore është bërë për një afat 2 muaj dhe 24 ditë. 2 seanca e tjera janë planifikuar për një afat nën 30 ditë. Planifikimi i seancës së parë gjyqësore është bërë për një afat 2 muaj e 2 ditë. Planifikimi i seancave gjyqësore vetëm në 2 raste rezulton të jetë mbi 30 ditë. Lidhur me veprimet përgatitore të gjyqtares rezulton se nga 3 seanca të planifikuara dhe të zhvilluara, kanë qenë të 3 seancat produktive, palët janë njohur me akte dhe provat respektive, kanë plotësuar të metat e padisë dhe në fund është vendosur kalimi i gjykimit në seancë gjyqësore. Shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore: rezultojnë të jenë planifikuar 19 seanca gjyqësore nga të cilat kanë 4 seanca kanë rezultuar joproduktive, 1 për mungesë të anëtarit A.A.; 2 seanca për mungesë të përfaqësuesit të palëve ndërgjyqëse për shkaqe të justifikuara dhe 1 seancë për tu njohur përfaqësuesi i ndryshuar i paditësave me aktet e dosjes. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: 1 seancë është shtyrë për tu njohur pala e paditur me provat e paraqitura rishtaz nga pala paditëse; 1 seancë është shtyrë për të paraqitur pala paditëse prova shtesë; 11 seanca janë shtyrë për marrjen e provës

me ekspert; 1 seancë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare dhe seancën e fundit është shpallur vendimi përfundimtar. Në raportin Inspektoratit të KLD është konkluduar se në rastin konkret shkaqet e shtyrjes së gjyqimeve në tërësinë e tyre rezultojnë të jenë për shkaqe procedurale dhe të justifikuara me qëllim hetim të plotë gjyqësor dhe zgjidhje të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Në këndvështrimin të të gjitha seancave, rezultojnë se më përjashtim të 4 seancave të cilat kanë rezultuar joproduktive, të tjerat janë qenë produktive, duke u fokusuar në marrjen e provës me ekspert, provë kjo e domosdoshme në zbatim të vendimit unifikues nr.12/2007 të Gjykatës së Lartë, pa evidentuar problematikë në këtë drejtim.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore (*duke përfshirë këtu edhe dy çështjet e verifikuara për zvarritje gjykimi nga KLD*), sikundër analizohen edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së pasi 6 prej tyre janë gjykuar tej këtij afati, duke përbërë **42.8%** të çështjeve të gjykuara jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 42.8% përkon me nivelin e vlerësimit 1 (një) pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në kontekst sa më sipër arsyetohet u analizua kompleksiteti i çështjeve, i përcaktuar në Metodologji si një nga komponentët që mund të çojë në pikëzim më të lartë se ai që rezultojnë nga analiza matematikore nga e cila rezultoi se:

1. Çështja që i përket vendimit civil nr.61, datë 15.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt të padisë: *“Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror”*. Referuar të dhënave rezultojnë se çështja është shortuar në datë 14.02.2014 dhe datë përfundimi 15.01.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 11 muajsh, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD. Afati tejkallimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 5 muaj, por këtu duhet të mbahet në vëmendje edhe fakti se muaji gusht (30 ditë) përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve, e në këtë kontekst nuk duhet të përlogarit në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar me 4 muaj tej standardit. Nga të dhënat e dosjes rezultojnë se çështja është regjistruar në gjykatë më 13.02.2014 dhe me shortin e datës 14.02.2014, ajo i është caktuar gjyqtarës {...}. Me vendim të datës 17.02.2014 (*pas 3 ditëve*) gjyqtarja ka vendosur caktimin e seancës përgatitore në datën 18.03.2014, ora 12:00. Data e caktuar e seancës dhe aktet e njoftimit respektojnë afatin 10 ditor të përcaktuar nga neni 155 i K.Pr.Civile. Nga të dhënat rezultojnë se janë 10 seanca të zhvilluara (*1 seanca përgatitore dhe 9 seanca gjyqësore*), nga të cilat vetëm 1 prej tyre nuk ka qenë efektive. Konkretisht, seanca gjyqësore e datës 02.07.2014, ora 10:00 nuk është zhvilluar pasi përfaqësuesi me prokurë i palës paditëse nuk është paraqitur për shkaqe shëndetësore. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale. Rezultojnë, gjithashtu që seancat gjyqësore janë lënë në afate të afërta me njëra - tjetrën nga 12 ditë deri në 1 muaj, me përjashtim të seancës datë 02.07.2014 e cila është shtyrë për një afat më të gjatë (pas 79 ditësh) për shkak të muajt gusht, si dhe seancës datë 03.12.2014 e cila është shtyrë pas 43 ditësh, për shkak se periudha e fund vitit përkon me procesin administrativ të mbartjeve të dosjeve nga administrata gjyqësore. Pra, ecuria procedurale, shkalla e kompleksiteti të çështjes, shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore, si dhe mënyra e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes duhet të mbahen parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimitin e gjyqtarës.

2. Çështja civile me nr. 9912/1194/371 regj., datë 09.04.2014 me palë paditëse A.B., kundër të paditurit I.F., me objekt të padisë *“Lirim, dorëzim sendi”*, përfunduar me vendimin nr. 6395 datë 18.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar të dhënave të dosjes konstatohet se gjykimi i kësaj çështje ka zgjatur për një afat prej 2 vjet, 3 muaj e 4 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD-së. Afati tejkallimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 1 vit, 9 muaj e 4 ditë, por këtu në ecjen e afatit të gjyqimit të çështjes nuk duhet të përlogarit periudha e pushimeve vjetore (*në muajin gusht 2014 dhe muajin gusht 2015*)

të cilat e rrisin edhe me 2 muaj përfundimin e gjykimit të çështjes. Gjithashtu, në ecjen e afatit të gjykimit ka ndikuar edhe shqyrtimi i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarës të paraqitur nga pala e paditur, e cila rezultoi në jetë paraqitur në datën 17.12.2015 dhe është shqyrtuar në datën 02.02.2016, duke e rritur këtë afat edhe me 1 muaj e 27 ditë. Në këtë kontekst, nëse do të zbrisim periudhat e mësipërme (3 muaj e 27 ditë) do të rezultonte që çështja do të kishte përfunduar nga ana e gjyqtarës {...} për një kohë prej 1 vit, 11 muaj e 7 ditë nga momenti i marrjes së kësaj çështje në short. Kjo çështje nuk mund të konsiderohet në afat pasi pavarësisht faktit se në përgjithësi shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore kanë qenë në funksion të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, tejkalimi i afatit me 1 vit, 5 muaj e 7 ditë nuk e justifikon atë.

3. Kërkesa tregtare me nr.13920/3518 regj., datë 13.11.2015 regjistrimi, me objekt të kërkesës “*Likuidim me procedure të përshpejtuar*”, ka përfunduar me vendimin nr.1373, datë 23.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar të dhënave të dosjes rezultoi se çështja është shortuar në datë 17.11.2015 dhe datë përfundimi 23.02.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 98 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 2 muaj ose 60 ditë të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është vetëm 38 ditë. Me vendim të datës 20.11.2015 (pas 3 ditëve) gjyqtarja ka vendosur caktimin e seancës përgatitore në datën 14.01.2016, ora 12:30, ndikuar kjo edhe nga procesi i mbartjeve të dosjeve. Seanca përgatitore e datës 14.01.2016, ora 12:30 është shtyrë për në datën 09.02.2016 me qëllim lënien kohë palës kërkuese për të plotësuar të metat e kërkesës, ndërsa në seancën përgatitore të datës 09.02.2016 çështja ka kaluar në seancë gjyqësore, në datë 23.02.2016, ku rezultoi të ketë përfunduar dhe gjykimi me vetëm një seancë gjyqësore. Në këtë kontekst, nëse do të zbrisim periudhën që gjykata i ka lënë palës kërkuese për plotësimin e të metave (26 ditë), si dhe periudhën që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata (15 ditë) do të rezultonte që çështja do të kishte përfunduar nga ana e gjyqtarës {...} për një kohë prej 57 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 60 ditësh.

4. Çështja që i përket vendimit civil nr.8293, datë 02.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt padie “Lirim, dorëzim sendi dhe shpërblim për përdorimin e sendit”. Referuar të dhënave të dosjes rezultoi se çështja i është caktuar gjyqtarës me short në datë 16.12.2014 dhe ka përfunduar në datë 02.11.2015, duke përfunduar brenda një afati prej 10 muaj e 16 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është 4 muaj e 16 ditë, por këtu duhet të mbahet në vëmendje edhe fakti se muaji gusht (30 ditë) përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve e në këtë kontekst nuk duhet të përlllogaritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar vetëm rreth 3 muaj e 16 ditë tej standardit. Referuar ecurisë procedurale të çështjes rezultoi se gjatë gjykimit nga ana e gjykatës është pranuar kërkesa për ndryshimin e objekti të padisë, si dhe është disponuar për marrjen e provës me ekspert, për të cilat ka qenë e nevojshme shtyrja e seancave gjyqësore. Kjo ecuri procedurale dhe kjo shkallë kompleksiteti duhet të mbahet parasysh nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimin e gjyqtarës.

KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës logjike të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuara si më sipër cituar, që rezultoi në masën 42.8%;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës por që lidhen me ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, etj.;
- (iii) treguesin sasior të punës gjatë periudhës së vlerësimit gjatë së cilët gjyqtarja ka përfunduar 1452 nga të cilat 580 çështje themeli, duke e tejkaluar standardin minimal sasior “jo më pak se 360 çështje për 3-vjet”, me më shumë se 61%, në raport me standardin minimal sasior i punës sipas “Kriterëve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së;

- (iv) natyrën orientuese dhe jo detyruese të këtyre standardeve kohore, ku hapësira e vlerësimit është me e gjerë se treguesi i “Respektimit të afateve ligjore”;
- (v) analizën jo vetëm matematikore, por edhe logjike të të dhënave statistikore, nga ka rezultuar jo vetëm gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, por edhe gjatë procesit të hetimit disiplinor për njëri nga çështjet si dhe gjatë analizës së të gjitha dosjeve burim vlerësimi, se zgjatja e gjykimeve kryesisht në dy prej çështjeve civile të analizuara më lart, nuk ka ardhur për shkaqe që lidhen me mënyrën e menaxhimit të çështjes nga ana e gjyqtarës, por me nevojshmërinë e kryerjes së veprimeve procedurale;
- (vi) pamundësinë objektive për të lënë zhvillimin e seancave përgatitore e atyre gjyqësore në një kohë më të afërt nga seanca paraardhëse, për shkak të natyrës së veprimit procedural si dhe ngarkesës totale në punë të gjyqtarës,

pavarësisht përqindjes së mësipërme, për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet maksimalisht. Ky vlerësim bazohet në parimin e parashikuar nga neni 93 pika 2 e Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit aftësia e gjyqtarit lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve duhet të analizohet sipas situatës, duke shmangur përfundime për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Aftësia e gjyqtarit për respektimin e standardit minimal, nuk mund të barazohet vetëm me treguesin e shifrës apo të dhënës statistikore, pasi në rastin konkret ka qenë e mundur të analizohet çdo dosje gjyqësore, ku çështja ka përfunduar tej standardit minimal, analizë nga ka rezultuar që zgjatja ka ardhur për shkak kompleksiteti, sjellje të palëve, respektimit të të drejtave procedurale të palëve dhe nevojës për hetim gjyqësor të plotë e gjithëpërfshirës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i çështjeve jashtë standardit minimal, ka ardhur për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykatat e Shkallës së Parë në periudhën e vlerësimit. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe 2 dosjeve të referuar nga ish KLD si më sipër cituar, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori, rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 10 çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë rreth 319 ditë, ose 10 muaj e 19 ditë, *pra më e gjatë se standardi minimal kohor* prej 6 muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 çështje në kategorinë e çështjeve “Tregtare me palë kundërshtare”, rezulton të jetë 159 ditë, ose 5 muaj e 9 ditë, *pra më e shkurtër se standardi minimal kohor* prej 6 muaj për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 çështje në kategorinë e çështjeve kërkesa pa palë kundërshtare, rezulton të jetë 61 ditë, *pra e barabartë me standardin minimal kohor* prej 2 muajsh për gjykimin e çështjeve pa palë kundërshtare në Gjykatën e Shkallës së Parë.

KONKLuzioni

Referuar analizës matematikore si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, tejkalohe vetëm për një kategori (*civile me palë kundërshtare*), si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, ky tregues pikëzohet maksimalisht me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dhomën civile. Ajo ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1713 çështje, ka përfunduar gjithsej 1404 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 102 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në të dhënat statistikore është 81,9%*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 1452 çështje nga të cilat 537 çështje civile të përgjithshme, 42 çështje tregtare, 1 çështje penale, 2 kërkesa penale, 284 kërkesa penale në fazën e hetimit (masa sigurimi) dhe 585 kërkesa civile, ose 580 çështje me palë kundërshtare sipas standardit.

Për aspektin sasior, sipas pikës 3, germa “e” të vendimit të ish KLD-së, gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 120 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, i llogaritur në periudhë 3-vjeçare jo më pak se 360 çështje themeli.

Referuar të dhënave të pasqyruara në tabelën e të dhënave statistikore, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit,⁶⁰ shënohen të dhënat statistikore të ndara sipas viteve kalendarike dhe konkretisht:

- Në vitin e plotë 2013, i janë caktuar si çështje të reja 256 çështje, ka përfunduar 170 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 86 çështje;
- Në vitin e plotë 2014, i janë caktuar si çështje të reja⁶¹ 448 çështje, ka përfunduar 428 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 106 çështje;
- Në vitin e plotë 2015, i janë caktuar 548 çështje, ka përfunduar 553 çështje, duke mbartur për vitin pasardhës 101 çështje;
- Në vitin e plotë 2016, i janë caktuar 424 çështje, ka përfunduar 423, duke mbartur për vitin pasardhës 102 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së 08.10.2013-08.20.2016, duke u bazuar në të dhënat statistikore bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit për periudhën e plotë 2013-2016, e cila në këtë rast konsiderohet periudhë e plotë vlerësimi, rendimenti duhet të përcaktohet referuar raportit të çështjeve të përfunduara 1574 çështje, me çështjet e caktuara 1676 çështje gjatë periudhës së vlerësimit, **në masën 93,9%.**

⁶⁰Faqe 12-13 të dosjes së rivlerësimit

⁶¹“Çështje te reja” janë ato që janë regjistruar të reja brenda një viti kalendarik, duke hequr çështjet e mbartura nga vitet paraardhëse.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtare për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 93.9%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”*. Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, duke përjashtuar vitin 2013, pasi gjyqtarja është kthyer në punë nga leja e barrë lindjes në shtator 2013, rezulton se gjyqtarja (i) për vitin 2014 ka përfunduar 210 çështje me palë kundërshtare, ose rreth 75% më shumë se standardi; (ii) për vitin 2015 ka përfunduar 190 çështje me palë kundërshtare, ose rreth 58% më shumë se standardi dhe (iii) për vitin 2016 (deri në 08.10.2016) ka përfunduar 159 çështje me palë kundërshtare, ose 76.6% më shumë se standardit sasior të punës (duke llogaritur për periudhën 9 mujore), për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që rezulton nga të dhënat statistikore. I njëjti përfundim do të arrij edhe nëse viti 2013 gjatë së cilit gjyqtarja ka punuar vetëm 4/muaj do të përjashtohej nga llogaritja e rendimentit, cili për periudhën e plotë 3/vjeçare 2014-2016, **rezulton në masën 98,8%.**

Shkalla e aftësisë së gjyqtare dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja pikëzohet me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i kushton rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, për të mos patur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj pas 4 ditësh (shih dosjen 1), pas 7 ditëve (shih dosjen 5), pas 8 ditëve (shih dosjen 4), pas 9 ditëve (shih dosjen 2) dhe pas 10 ditëve (shih dosjen 3). Konstatohet se vetëm dosja e pestë penale është dorëzuar jashtë afatit ligjor 5 ditor, pas 7 ditëve nga shpallja, vetëm dy ditë pas këtij afati, ndërsa katër vendimet civile janë dorëzuar brenda afatit ligjor 10 ditor të parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile. Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja {...} ne përgjithësi ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka patur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal dhe i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyetimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore”.*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10/ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5/ditë. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10-ditor i ankimit ndaj vendimit penal dhe afati 10-ditor i arsyetimit të vendimit civil sipas parashikimeve të nenit 308/2 të K.Pr.Civile.

Sa më sipër, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- Çështja civile nr. 8357/994 regj., datë regjistrimi 13.02.2014, me objekt të padisë *“Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror”*, e përfunduar me vendimin nr. 61, datë 15.01.2015. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 19.01.2015, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Në çështjen civile nr. 15348 regj., datë regjistrimi 06.11.2014, me objekt *“Vërtetim fakti juridik”*, përfunduar me vendimin nr.11582, datë 03.12.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 11.12.2014, pra 8 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Në çështjen civile nr. 9912/1194/37131 regj., datë regjistrimi 09.04.2014, me objekt të padisë *“Lirim, dorëzim sendi”*, përfunduar me vendimin nr.6395, datë 18.07.2016. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 28.07.2016, pra 10 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Në çështjen tregtare nr. 13920/3518 regj., datë regjistrimi 13.11.2015, me objekt *“Likuidim procedure të përshpejtuar të kompanisë”*, përfunduar me vendimin nr. 1373, datë 23.02.2016. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën

03.03.2016, pra 9 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

- (v) Në çështjen penale nr. 1203 regj., datë regjistrimi 31.10.2013, me objekt "*Vleftësim arrësit dhe caktim mase sigurimi*", përfunduar me vendimin e datës 01.11.2013. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 08.11.2013, pra 7 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013 - 2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- (vi) Në çështjen civile nr. 6244 regj., datë regjistrimi 18.11.2013, me objekt të padisë "*Përjashtim sendi nga sekuestrimi*", përfunduar me vendimin nr.956, datë 27.01.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 31.01.2014, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (vii) Në çështjen civile nr. 6915 regj., datë regjistrimi 20.12.2013, me objekt të padisë "*Dëmshpërblim që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës*", përfunduar me vendimin nr.5353, datë 30.04.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 05.05.2014, pra 5 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (viii) Në çështjen civile nr. 12800 regj., datë regjistrimi 18.07.2014, me objekt të padisë "*Pavlefshmëri titulli ekzekutiv*", përfunduar me vendimin nr.11064, datë 17.11.2014. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 27.11.2014, pra 10 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (ix) Në çështjen tregtare nr. 12409/1747 regj., datë regjistrimi 04.07.2014, me objekt "*Pushim cenimi i të drejtës së pronësisë mbi markat tregtare*", përfunduar me vendimin nr. 615, datë 03.02.2015. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 16.02.2015, pra 13 ditë nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (x) Në çështjen civile nr. 16536/4042 regj., datë regjistrimi 15.12.2014, me objekt të padisë "*Lirim, dorëzim sendi*", përfunduar me vendimin nr.8293, datë 02.11.2015. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 06.11.2015, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- (xi) Në çështjen civile nr. 14355 regj., datë regjistrimi 26.11.2015, me objekt të padisë "*Pavlefshmëri absolute e veprimeve juridike të kontratës së dhurimit*", përfunduar me vendimin nr.1816, datë 07.03.2016. Referuar shënimit të bërë në librin e dorëzimit rezulton se dosja është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore në datën 11.03.2016, pra 4 ditë nga shpallja e vendimit, brenda afatit 10 ditor përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

Referuar çështjeve sipas kategorive të tyre, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar

- (i) për kategorinë "Civile të përgjithshme me palë kundërshtare" është 5.6 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (ii) për kategorinë "Çështje civile pa palë kundërshtare", është 10 ditë, e barabartë me afatin 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (iii) për kategorinë "Çështje tregtare me palë kundërshtare", është 13 ditë, më e gjatë se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile;
- (iv) për kategorinë "Çështje tregtare pa palë kundërshtare", është 9 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor i përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile
- (v) për kategorinë "Kërkesa penale të fazës së hetimit paraprak", është 7 ditë, më e shkurtër se afati 10 ditor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si "*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për shumicën e kategorive të çështjeve*". Pavarësisht analizës matematikore, referuar asaj logjike ku vlerësuesi mban në konsideratë afatin 3/ditor të tejkalimit,

faktin se ky tejkallim konsiderohet i papërfillshëm, duke pasur në konsideratë se nuk tejkalohe afati 15 ditor i të drejtës së ankimi, si dhe tejkallimi konstatohet vetëm në një kategori çështjesh (çështje tregtare), referuar edhe ngarkesës në punë të gjyqtarës, duke aplikuar koeficientin 20% të rritjes me 1 shkallë pikëzimi, për këtë kriter gjyqtarja pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsyesimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCEVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 4 çështjet civile të vëzhguara, ajo ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 4). Në këto 4 raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal të rregullt nga pikëpamja formale. Në 4 çështjet civile, gjykimet kanë përfunduar me 10, 2, 32 e 3 seanca. Ndërsa çështja adm-penale e vëzhguar, që lidhet me vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal, ka përfunduar me 1 seancë (shih dosjen 5). Konkretisht, janë vëzhguar 48 seanca gjyqësore, nga të cilat 35 kanë qenë produktive. Pengesë në 13 seanca joproduktive kanë qenë; kërkesat për shtyrje të palës së paditur (4 seanca), për mosparaqitje të palës së paditur (3 seanca), me kërkesë për shtyrje të ekspërteve (2 seanca), me kërkesë për shtyrje të palës paditëse (1 seancë), me kërkesën e palëve për zgjidhjen me pajtim të çështjes (2 seanca), për paraqitjen e provave të reja (1 seancë)”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Nga tërësia e të dhënave rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 8⁶² çështjet e vëzhguara dhe në 2⁶³ vendimet e për zgjedhura prej saj me palë kundërshtare (çështje civile themeli dhe çështje tregtare) varion nga 2 deri në 28 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 7.8 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” dhe 2.5 seanca gjyqësore për çështje të kategorisë “*Çështje tregtare*”. Ndërkohë nëse në lidhje me këtë kriter do të përlllogarisim edhe seancat gjyqësore (17 dhe 19 seanca gjyqësore) në dy çështjet civile të referuar për efekt vlerësimi, atëherë numri mesatar i seancave gjyqësore në kategorinë e çështjeve “*Civile të përgjithshme me palë kundërshtare*” do të rritet në 9.9 seanca gjyqësore.

Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 10 çështjet me palë kundërshtare të analizuar, rezulton të jetë 6.8 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të për zgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka kryer me korrektësi dhe efikasitet veprimet procedurale për vënien në lëvizje të dosjeve brenda një kohë të shkurtër nga 0⁶⁴ deri në 6 ditë nga momenti i caktimit të tyre me short. Rezultoni se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët apo mos zhvillimin i seancave përgatitore dhe gjyqësore për shkak të mungesës së tyre. Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore, në referim të nenit 158/a të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar në akt në mënyrë të qartë urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile.

Seancat gjyqësore rezultojnë se janë shtyrë për shkaqe të përligjura dhe kryesisht për marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjykimin nga të tretët; për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse dhe mbrojtësit të saj për shkaqe të përligjura; për të mundësuar njoftimin dhe pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit; për të paraqitur prova në dobi të gjykimit; për zgjidhjen me pajtim të çështjes; për njoftimin e ekspertit të caktuar nga gjykata; për përgatitjen e aktit të ekspertimit; për mosparaqitjen e ekspertit; për njoftimin e kërkesës për ndryshimin e objektit të padisë palëve në mungesë; me kërkesë të palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, si dhe për shpalljen e vendimit të arsyetuar në disa raste. Nga të gjitha seancat gjyqësore të vëzhguara, në asnjë rast nuk rezulton që seanca të mos jetë zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues.

Përgjithësisht seancat gjyqësore janë planifikuar brenda një afati të arsyeshëm, në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg, përveçse kur kjo ka qenë objektivisht e pamundur (*për shkak të pushimeve në muajin gusht*). Në çdo rast është respektuar afati procedural 5 ditor kur seanca është shtyrë për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 305 të K.Pr.Civile, apo shpalljen e arsyetuar të vendimit, sipas përcaktimeve të nenit 308 të K.Pr.Civile.

⁶²Duke përjashtuar çështjet pa palë kundërshtare, konkretisht dosjen nr.2, me objekt “*Vërtetim fakti juridik*”; dosjen nr.4 me objekt “*Kërkesë për likuidim me procedurë të përshpejtuar*” dhe dosjen nr.5, me objekt “*Vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi*”

⁶³Duke përjashtuar vendimin nr.5015, datë 16.06.2015 me objekt “*Shtyrje e afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla*”, pasi është çështje pa palë kundërshtare

⁶⁴Shih dosjen me nr.6395 vendimi, datë 18.07.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Referuar sa më sipër, për treguesin e “Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është mbi 3 seanca, por nga ana tjetër gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Prandaj pavarësisht se numri mesatar i seancave është më i lartë se 3 (vetëm në çështjet civile të përgjithshme), gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 vetëm për një kategori çështjesh, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësisë profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Gjatë gjykimit, ajo

identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, prapësimet e tyre, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar i palëve e gjer tek shpallja e vendimit”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve civile me palë kundërshtarë dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak.

Gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore menjëherë ose deri në 6 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës të mbajtur nga sekretarja gjyqësore, në disa raste procesverbali është mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio. Shkak i mos zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore me sistemin audio ka qenë për arsye administrative dhe funksionaliteti në gjykatën pranë se cilës ka ushtruar funksionin gjyqtarja në periudhën e vlerësimit (*për shkak të pamundësisë së zhvillimit të seancës gjyqësore në sallë*). Pavarësisht këtij shkak, seancat të cilat nuk janë zhvilluar me sistemin audio janë dokumentuar me procesverbal gjyqësor me shkrim të mbajtur nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke urdhëruar njoftimet përkatëse për palët. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile (*nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile*) dhe në kërkesën penale (*nenet 259 dhe 341 të K.Pr.Penale*). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, legjitimitimin e mbrojtësit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje te vëzhguara, konstatohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarës në drejtim të planifikimit dhe menaxhimit të seancave gjyqësore të cilat përgjithësisht janë çelur në kohën e përcaktuar dhe vetëm në disa raste me vonesa të papërfillshme që shkojnë nga 2 deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë” duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Dosjet janë të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e paraqitura nga palët dhe më pas ato të krijuara nga gjykata. Aktet janë administruar në referencë të rregullave procedurale civile apo penale dhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve procedurale dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke përmbajtur kërkesën/kërkesëpadinë, aktet e përfaqësimit të palëve, provat e paraqitura nga ana e palëve ndërgjyqëse, vendimi për caktimin e seancës përgatitore, njoftimet dhe shkresat e gjykatës sipas datave, seancat përgatitore të zhvilluara sipas datave, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbali i seancës gjyqësore sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se në përgjithësi ato kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 4) ose procedurale penale (shih dosjen 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e përfaqësimit, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura, ndërsa edhe në dosjen penale gjendet i administruar vendimi i gjyqtarës për caktimin e seancës gjyqësore (shih dosjen 5). Por jo të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezulton se janë të plota e me të gjitha të dhënat, pasi në kundërshtim me kërkesat e nenit 118, pika “ç” të K.Pr.Civile, mungojnë gjeneralitetet e pjesëmarrësve në gjykim, e konkretisht të paditësit (shih dosjen 1) dhe të paditësit e të paditurve (shih dosjen 3). Procesverbalet gjyqësore rezultojnë të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtarja, konform kërkesave të nenit 118 të K.Pr.Civile dhe 345 të K.Pr.Penale. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë...”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimet për vënien në lëvizje të

çështjes, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve si prokura autorizime ekstrakte të regjistrit tregtar, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve, etj.). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.*

Nga aktet e dosjes së rivlerësimit, rezulton se në të nuk janë administruar aktet lidhur me verifikimin e ankesave. Për këtë arsye, u administruan nga arkiva e KLGJ, aktet përkatëse për verifikimin e secilës ankesë. Nga administrimi i tyre rezulton se, pas trajtimit, ankesat janë arkivuar dhe vetëm 2 (dy) prej tyre, përmbajnë të dhëna që përbëjnë burim vlerësimi e që janë analizuar në kriterin e “Aftësive Organizative” të gjyqtarës.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD, trajtuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij raporti, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarën {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.344, datë 11.02.2021 rezulton se për subjektin e rivlerësimit {...} janë paraqitur 14 denoncime, nga të cilat, për 4 prej tyre i janë kërkuar shpjegime subjektit. Pas verifikimit, KPK ka konkluduar lidhur me secilin prej tyre, duke i shqyrtuar dhe trajtuar në kuadër të vlerësimit profesional, por në përfundim janë gjetur të pabazuara. Në vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit me nr.17, datë 27.05.2022, nuk rezultojnë të jenë verifikuar apo trajtuar çështje që mund të ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës, posaçërisht në drejtim të etikës së saj në punë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” shkalla e aftësisë së gjyqtarës është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtë”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren janë paraqitur gjithsej 6 (gjashtë) ankesa në Inspektoratin e ish KLD.⁶⁵ Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së me nr. 344, datë 11.02.2021 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit me vendimin nr.17, datë 27.05.2022 në lidhje me etikën, kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, ka konkluduar si vijon: *“Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se: • Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë. • Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës...”*

Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në vendimi nr.17, datë 27.05.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, konkludohet se: *“23.2 Bazuar në rrethanat specifike dhe objektive të çështjes në shqyrtim, në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit, për mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pasurinë cash, si dhe shlyerjen e huas për vitet 2011 dhe 2013, Kolegji çmon se vendimi i Komisionit nr. 344, datë 11.02.2021, i*

⁶⁵Sikurse pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij raporti, të titulluar “Burimet e vlerësimit”

cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. {...} (Nuni), është marrë në vlerësim të drejtë të fakteve dhe provave të rezultuara gjatë hetimit administrativ e në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Ky vlerësim i Kolegjit mbajti në konsideratë edhe arsyetimin e ndryshëm të Komisionerit Publik për këtë fakt, i cili në përfundim të gjyqimit të çështjes, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

24. *Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.*

25. *Për rrjedhojë, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi”.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 (tre) vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe aktet e 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se: *Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve....”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi

kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (*11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja*) rezulton se për gjyqtaren {...} është paraqitur një kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjes. Konkretisht, referuar akteve të dosjes me nr.6395 vendimi, datë 18.07.2016, rezulton se gjatë gjykimit të çështjes civile, në seancën e datës 07.12.2015 është kërkuar nga ana e përfaqësuesit të palës së paditur përjashtimi i gjyqtarës {...}. Kërkesa është shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues, për të cilën është disponuar mbi pushimin e gjykimit.

Nga ana tjetër, nga tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, rezulton se nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës vlerësohet si “*I pakonsiderueshëm*”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës*” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “*I pakonsiderueshëm*”.

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se: *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e saj...”*

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre dhe në çdo rast duke respektuar normat e komunikimit zyrtar dhe etik.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e provave nga të tretët, etj.*) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar 3 (tre) vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të 8 rastet, subjekti i rivlerësimit ka qënë gjyqtare e

vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzim: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi, si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social etj., vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtares me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indice për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në 15 aktivitete trajnuese, në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, në të gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej në 27 ditë trajnim.

Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnime jashtë Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, të cilat rezultojnë të jenë aktivitete të formimit profesional. Konkretisht, gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin me temë “Etika gjyqësore”, e organizuar nga OPDAT (*Office of Overseas Prosecutorial Development, Assistance and Training*), në Tiranë, në datën 11 prill 2014 dhe në programin “BNM-WBG Credit Infrastructure Programme”, të organizuar nga World Bank Group dhe Bank Negara Malaysia, në Malajzi, nga data 4-8 prill 2016.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 17 aktivitete trajnuese, në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 33 ditë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile dhe procedurale civile, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 33 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve ligjore 15-120 ditë, duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatë për magjistratë, rezulton se gjyqtarja {...} përgjatë periudhës së vlerësimit ka udhëhequr kandidatë për magjistratë për kryerjen e stazhit profesional. Konkretisht (i) me urdhrin e datës 09.10.2013 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është caktuar gjyqtare udhëheqëse për kryerjen e praktikës paraprofesionale, për periudhën 7-24 dhjetor 2013, për kandidaten për magjistrate znj.Yrfet Shkreli; (ii) me urdhrin nr.186, datë 10.12.2015 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është caktuar gjyqtare udhëheqëse për kryerjen e stazhit profesional për kandidaten për magjistratë të vitit të tretë znj.Ersida Bajgora dhe (iii) me urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është caktuar gjyqtare udhëheqëse për kryerjen e praktikës paraprofesionale, për periudhën 03.10.2016-09.12.2016 për kandidaten për magjistrate znj.Amarilda Sulaj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se ka të dhëna, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton angazhimi i gjyqtares për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, formularit të vetëvlerësimit profesionale dhe dokumentacionit bashkëlidhur tij, rezulton angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë, siç është kontributi në hartimin legjislativ. Konkretisht, gjyqtarja ka dhënë kontributin në lidhje me hartimin e ligjit të ri për falimentin, në bashkëpunim me International Finance Corporation (IFC) përgjatë periudhës 19 tetor – 30 nëntor 2015.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, e në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me këtë kriter.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për gjyqtaren {...}, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	95

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE
NIVELI I PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM**

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	95	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	395	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

HTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë

					Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40%- 3 pikë 31-40% - 6 pikë 21-30% - 9 pikë 11-20% - 12 pikë 0-10% - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	0-10%	5	Jashtë afatit: Mbi 40%- 1 pikë 31-40% - 2 pikë

		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)			21-30% - 3 pikë 11-20% - 4 pikë 0-10% - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	+99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë

		<p>vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar 	të gjitha kategoritë e çështjeve		<p>Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë</p> <p>Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë</p> <p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë</p> <p>Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
B. Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarës: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e	a. Rregullshmëria e dokumentacionit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarës:

gjqtares për të administruar dosjen gjyqësore	të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 			E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short) 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)			diskriminuuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës	▪ Dosja e rivlerësimit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short)	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë

		<i>përzgjedhura me short)</i>			I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtares: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë

					Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			395		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			SHKËLQYESHËM		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR